



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:141291
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05740585

C.nr.2287/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.M., Komuna P., të cilin e përfaqëson M.I. avokat nga Peja, kundër të paditurit M.M. nga P. të cilin e përfaqëson H.I, sipas autorizimit, baza juridike vërtetim pronësie, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance, me datën 27.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE, me numër të lëndës Nd.nr.3../24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë, me datën 12.04.2024, e lidhur në mes S.M., Komuna P., të cilin e përfaqëson M.I. avokat nga Peja, kundër të paditurit M.M. nga P. të cilin e përfaqëson H.I, baza juridike vërtetim pronësie dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësi, nëpërmjet të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 23.06.2023 kundër të paditurit M.M. nga P., baza juridike vërtetim pronësie.

Në qendrën e ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë 12.04.2024.

Qendra për Ndërmjetësim, e ka njoftuar gjykatën se me datë 12.04.2024 palët ndërgjyqëse nëpërmjet të autorizuarve të tyre, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 426 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 15 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me datën 28.07.2018, pas shqyrtimit të njëjtës me datën 24.05.2024, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titullit përmbarues.

Numri i lëndës: 2023:141291
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05740585

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2287/23, me datë 27.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.